
	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 21.03.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: KRASNIQI shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi i objekteve për shkollat fillore në Komunë të Prishtinës”**, me Nr. të Prok: **616-23-1001-2-1-1**, Autoriteti Publik – Komuna e Prishtinës me datë: 21.03.2023 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet në tërësi kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: KRASNIQI shpk e parashtruar me datë: 21.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Pastrimi i objekteve për shkollat fillore në Komunë të Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-1001-2-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të AK –së, të datës 15.02.2022 të publikuar në web-faqe të KRPP-së, në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.**
2. Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin për të vazhduar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi i objekteve për shkollat fillore në Komunë të Prishtinës”**, me Nr. të Prok: **616-23-1001-2-1-1**.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Arsyetim

Autoriteti Publik me datë: 15.02.2023 ka bërë njoftimin për kontratë, ndërsa me datë: 15.03.2023 ka bërë korrigjimin e dosjes së tenderit me çka ka përmisuar kriteret e dosjes së tenderit në pikën 9.1 dhe 9.2 ku është bërë korrigjimi i kriterëve të dosjes së tenderit.

Poashtu Autoriteti Kontraktues ka bërë korrigjimin e dosjes së tenderit edhe sa i përket listës së makinerisë.

Andaj Pretendimet ankimore të OE ankimor KRASNIQI janë të pabaza edhe të paarsyesme dhe si të tilla janë pretendime ankimore që janë të bazuara në dosje të kaluara para se të ndodhte korrigjimi i dosjes së tenderit.

Ju lutem referojuni dosjes së korrigjuar të datës: 15.03.2023.

Andaj në bazë të asaj që është lartcekur autoriteti publik vendos si në dispozitiv.

Iu dorëzohet:

Departamentit të Prokurimit
Palës përmes sistemit elektronik - E-Prokurimi
Arkivit

Visar Shehu - U.D. - Departamenti i Prokurimit

